

Konsultimet nacionale me organizatat e shoqërisë civile

Zagreb, Kroaci

1. Qershor 2010.

Vërejtjet dhe sugjerimet për draftimin e Statusit të KOMRA-së

Vërejtjet dhe propozimet kryesore

Pra, e para që vërejtja, është ajo që së bashku me këtë Status do të jenë të nevojshëm edhe ligjet nacionale për bashkëpunim me KOMRA-në, pra nuk është vetëm status, por do të na duhet të shkruajmë ligjin për të gjitha këto procedura, të cilat nuk do të mund të pajtohen me status, dhe për këtë duhet menduar, por gjithsesi duhet të dalim me ligjin për bashkëpunim me KOMRA-në. (Goradan Bosanac, Qendra për Studimet e Paqes, Zagreb, Kroaci, Konsultimet Nacionale me Organizatat e Shoqërisë Civile, Zagreb, Kroaci, 1. qershor 2010)

(...) mendoj se është jashtëzakonisht e rëndësishme që anëtarët dhe anëtarët e komisionit të kenë qasje në dokumentet e klasifikuara, dhe mendoj se kjo çështje këtu nuk është precizuar mjaft. Kjo është çështje e kontrollit të masave të sigurisë. (Goradan Bosanac, Qendra për Studimet e Paqes, Zagreb, Kroaci, Konsultimet Nacionale me Organizatat e Shoqërisë Civile, Zagreb, Kroaci, 1. qershor 2010)

(...) nuk po më pëlqen që po quhet status, sepse kur flasim për statuset, do të thotë statusin e miraton një organ i formuar më parë, me të cilin e rregullon punën e tij. Mendoj se duhet të jetë kështu, sepse bëhet fjalë për më shumë shtete nënshkruese, të cilat e nënshkruajnë një dokument, dhe i cili pastaj në formë të një marrëveshjeje ndërkombëtare shkon në miratim te kuvendet kombëtare, dhe sipas të gjitha kushtetutave të shteteve ajo marrëveshje bëhet ligj, gjegjësisht marrëveshjeje ndërkombëtare e cila do të jetë mbi ligjet nacionale. Mendoj se ky nuk duhet të quhet status. (Ivan Novosel, Legalis, Zagreb, Kroaci, Konsultimet Nacionale me Organizatat e Shoqërisë Civile, Zagreb, Kroaci, 1. qershor 2010)

Pra, ajo që unë propozoj për këtë dokument themelor, të cilin nuk po di si ta quaj, të jetë mandati (kompetenca) i komisionit dhe të caktohet territori i veprimit, zona, dhe kompetenca e komisionit dhe kështu pastaj segmentet tjera. Ajo çfarë mendoj se kursesi nuk duhet të jetë në këtë tekst, është para se gjithash, ai tekst duhet të jetë ligjërishit relevant, e në anën tjetër duhet të jetë i kuptueshëm, pra ai duhet së pari të jetë i kuptueshëm për viktimat dhe për opinionin e gjerë i cili nuk është ligjërishit i arsimuar, por duhet të jetë ligjërishit relevant. Në këtë rast ai bëhet ligj, ligj i atij shteti, duhet të ndahet nga dokumenti personal, por këto detale janë teknike që kanë të bëjnë me zgjedhjet, mënyrën e zgjedhjeve dhe para se gjithash me Panelin Përzgjedhës. (Ivan Novosel, Legalis, Zagreb, Kroaci, Konsultimet Nacionale me Organizatat e Shoqërisë Civile, Zagreb, Kroaci, 1. qershor 2010)

Vërejtjet dhe sugjerimet sipas neneve

Neni 1.

Mendoj se nëse duam t'i evidentojmë humbjet në njerëz, të marrim parasysh faktin se shumë njerëz janë vrarë, por jo në krime të luftës, kështu që ata do të mirren edhe me te, kjo nuk është as krim lufte e as shkelje e rëndë e drejtave të njeriut, ajo çka e nënkupton atë, por është një fakt për konflikt të armatosur që një ose ai ushtar është vrarë në luftë. Nëse duam ti shkruajmë humbjet në njerëz, na duhet ky formulim sepse thjeshtë është tjetra nëse hiqet mbyllet. (Mario Mazhiq, Iniciativa për të Drejtat e Njeriut, Zagreb, Kroaci, Konsultimet Nacionale me Organizatat e Shoqërisë Civile, Zagreb, Kroaci, 1. qershor 2010)

(...) duke përfshirë, sigurisht jo vetëm propagandën e mediave por edhe politikën, dhe të gjitha të tjerat, kur është zhvilluar cila luftë, ku kanë sulmuar, kush kënd e ka granatuar... Mendoj se vërtetimi i fakteve për krimet e luftës do të marrë shumë kohë dhe kapacitete. (Igor Roginek, Dokumenta, Kroaci, Konsultimet Nacionale me Organizatat e Shoqërisë Civile, Zagreb, Kroaci, 1. qershor 2010)

Kur ka filluar Iniciativa, ka filluar me fokusin në viktimën, gjegjësisht që do të numërojmë viktimat e krimeve të luftës dhe shkeljeve të rënda të drejtave të njeriut. Kurrë më parë në debate nuk është cekë hulumtimi i fakteve për krimet e luftës. (Velko Viqueviq, UDVDR PGZ, Zagreb, Kroaci, Konsultimet Nacionale me Organizatat e Shoqërisë Civile, Zagreb, Kroaci, 1. qershor 2010)

(...) puna jonë bazë është që të kontribuojmë në kuptimin ose të arrijmë që shtetet tona të takohen dhe të bien dakord, dhe të thonë se sa kanë pasur të vrarë, sa ka të zhdukur, sa ka pasur krime lufte, sa ka pasur shkelje... Kjo është ajo që ne duam, dhe me këtë do të ndihmojmë të vërtetohen faktet: çfarë konflikti i armatosur ka qenë, çka ka ndodhë dhe të mos ndodhë më. (Katarina Kruhonja, Qendra për Paqe, kundër dhunës dhe të drejtat e njeriut, Osijek, Kroaci, Konsultimet Nacionale me Organizatat e Shoqërisë Civile, Zagreb, Kroaci, 1. qershor 2010)

Neni 2.

Emri

(...) ekziston dallimi terminologjik, dallimi konceptual mes shprehjeve territoret dhe hapësirat. Dhe, ai i cili e ka përpiluar këtë tekst, duhet ta dijë atë dallim („në hapësirat“ të zëvendësohet me „në territoret“). (Liliana Canjuga, UDVDR PGZ, Zagreb, Kroaci, Konsultimet Nacionale me Organizatat e Shoqërisë Civile, Zagreb, Kroaci, 1. qershor 2010)

Neni 4.

Selia

E para, selia e KOMRA-së është në Sarajevë. Shumë mirë. E përshëndes. (Tin Gazivoda, Qendra për të drejtat e njeriut, Zagreb, Kroaci, Konsultimet Nacionale me Organizatat e Shoqërisë Civile, Zagreb, Kroaci, 1. qershor 2010)

Serioziteti i propozimit kërkon përgjegjësinë nga ne që të kemi situatë shumë stabile atje ku propozojmë të jetë selia. Momentalisht ne e kemi situatën më jostabile në Bosnje e Hercegovinë. (Velko Viqueviq, UDVDR PGZ, Zagreb, Kroaci, Konsultimet Nacionale me Organizatat e Shoqërisë Civile, Zagreb, Kroaci, 1. qershor 2010)

Neni 5.

Periudha e veprimit

Ndoshta do të jetë më mirë nëse e vlerësojmë në bazë të disa përvojave krahasuese se janë të nevojshme dy vite e gjysmë, vetëm për të hyrë, periudha përgatitore gjashtë muaj dhe mandati i kohëzgjatjes dy vite e gjysmë apo tri vite. Pse të kufizohemi kaq shumë në këtë segment. Mund të zgjasë deri në tri vite. (Tin Gazivoda, Qendra për të drejtat e njeriut, Zagreb, Kroaci, Konsultimet Nacionale me Organizatat e Shoqërisë Civile, Zagreb, Kroaci, 1. qershor 2010)

Mendoj se mandati është tejet i shkurtë. Këtu bëhet fjalë për dy vite dhe gjashtë muaj përgatitje. Mendoj se kjo është kohë e shkurtë, duke pasur parasysh se kemi folur për atë se koha mesatare e punës së komisionit ka qenë mes dymbëdhjetë e tetëmbëdhjetë muaj, mendoj se këtu bëhet fjalë për një hapësirë të madhe me një numër të madh të viktimave, dhe këtu, unë do të dëshiroja të shkruante edhe gjashtë muaj, të paktën të shkruhet në paragrafin 2, të nenit 5, se KOMRA mund ta vazhdojë mandatin e saj për gjashtë

muaj. Unë do t'a leja këtë si opsion rezervë, e aty te kohëzgjatja bazë do të shtoja edhe gjashtë muaj për reproduksionin e raportit. (Ivan Novosel, Legalis, Zagreb, Kroaci, Konsultimet Nacionale me Organizatat e Shoqërisë Civile, Zagreb, Kroaci, 1. qershor 2010)

(...) unë propozoj që të jetë sa më shumë e mundur, pra veprimtaria e përgjithshme e mundur e komisionit, e jo të kufizohet në dy vite apo dy vite e gjysmë, e çka më vonë do të mund të jetë problem. (Slaven Rashković, Sokumenta, Zagreb, Konsultimet Nacionale me Organizatat e Shoqërisë Civile, Zagreb, Kroaci, 1. qershor 2010)

(...) definitivisht duhet të mbetet paragrafi i dytë, por nuk jam i sigurt sa është mirë që KOMRA ta vazhdojë afatin e saj, apo dikush tjetër. (Ivan Novosel, Legalis, Zagreb, Kroaci, Konsultimet Nacionale me Organizatat e Shoqërisë Civile, Zagreb, Kroaci, 1. qershor 2010)

Propozoj që themeluesit e KOMRA-së të mund ta vazhdojnë mandatin e KOMRA-së për gjashtë muaj. (Vesna Tersheliq, Dokumenta, Zagreb, Kroaci, Konsultimet Nacionale me Organizatat e Shoqërisë Civile, Zagreb, Kroaci, 1. qershor 2010)

Në fakt, kjo pjesë përfshinë periudhën, mund të interpretohet se në kuadër të kësaj periudhe faktikisht të përfshihet koha e përgatitjeve. Prandaj, propozoj që në vend të përfshinë të shkruhet fillon. Pra, atëherë mund të konkludohet se mandati fillon pas gjashtë muaj përgatitje, e jo se ato gjashtë muaj përgatitje të jenë pjesë në kuadër të mandatit. (Liliana Canjuga, UDVDR PGZ, Zagreb, Kroaci, Konsultimet Nacionale me Organizatat e Shoqërisë Civile, Zagreb, Kroaci, 1. qershor 2010)

Unë desha të propozoj zgjidhje paralele, e ajo është që megjithatë KOMRA vetë të vendosë për zgjatjen e mandatit të saj, e jo themeluesit. (Mario Mazhiq, Iniciativa për të Drejtat e Njeriut, Zagreb, Kroaci, Konsultimet Nacionale me Shoqëritë Civile, Zagreb, Kroaci, 1. Qershor 2010.)

Edhe ne jemi për shtyrjen e mandatit, të jetë së paku tri vite, që do të jenë gjashtë muajt e dytë shtesë për raportimin. (Katarina Kruhonja, Qendra për Paqe, kundër dhunës dhe të drejtave të njeriut, Osijek, Kroaci, Konsultimet Nacionale me Organizatat e Shoqërisë Civile, Zagreb, Kroaci, 1. qershor 2010)

Neni 7.

Përdorimi i gjuhës

(...) gjuhët e KOMRA-së të jenë të gjitha gjuhët e shteteve nënshkruese. Edhe raportet duhet të përkthehen në të gjitha gjuhët.

KOMRA, sigurisht do të flasë me vëzhgues ndërkombëtarë të ndryshëm të cilët janë, ku ta di, nga Suedia, Zvicra apo Holanda, dhe mendoj se duhet të vendosen dispozita se KOMRA mund të punojë në të gjitha gjuhët e botës që janë relevante, pra ato të cilat i flasin bashkëbiseduesit e KOMRA-së. (Mario Mazhiq, Iniciativa për të Drejtat e Njeriut, Zagreb, Kroaci, Konsultimet Nacionale me Organizatat e Shoqërisë Civile, Zagreb, Kroaci, 1. qershor 2010)

Kur themi gjuha zyrtare, mund të kemi problem. (...) ti marrim për shembull serbët e Baranjës, ata në rrethinën e Dubusheviçës flasin në dialektin ekavik, disa flasin në ijekavik. Për njeriun është më së lehti ta shpreh vuajtjen e tij në gjuhën të cilën ai e kutpon. (Veslinka Kastratović, Qendra për paqe, kundër dhunës dhe të drejtave të njeriut, Osijek, Kroaci, Konsultimet Nacionale me Organizatat e Shoqërisë Civile, Zagreb, Kroaci, 1. qershor 2010)

Neni 8.

Obligimi i bashkëpunimit të shteteve me KOMRA-në

Pra, nëse kjo për ne është pikënisje, atëherë ne në bazë të dëshmisë mund të kërkojmë, kur na ndeshen informatat, të kërkojmë të na jepet në shikim për vërtetim të informatës apo jo, dhe të evidentohet se ajo nuk na është dhënë. Dhe, mendoj se edhe kjo do të jetë fakt vetvetiu. (Liliana Canjuga, UDVDR PGZ,

Zagreb, Kroaci, Konsultimet Nacionale me Organizatat e Shoqërisë Civile, Zagreb, Kroaci, 1. qershor 2010)

Neni 9.

Objektivat e KOMRA-së

(...) ka gjëra që duhet të jenë në hyrje (preambulë), e jo qëllim. (Katarina Kruhonja, Qendra për Paqe, kundër dhunës dhe të drejtave të njeriut, Osijek, Kroaci, Kroaci, Konsultimet Nacionale me Organizatat e Shoqërisë Civile, Zagreb, Kroaci, 1. qershor 2010)

(...) nuk do të ishte keq, që në ndonjë mënyrë të ndahet kjo që ka të bëjë me qëllimet jashtëzakonisht konkrete, që i përket vërtetimit konkret të fakteve, sepse KOMRA, krahas asaj që do të bëjë hetime në terren, do të organizojë dëgjime publike dhe tjera, të themi, të asaj rëndësisë politike. (Mario Mazhiq, Iniciativa për të Drejtat e Njeriut, Zagreb, Kroaci, Konsultimet Nacionale me Organizatat e Shoqërisë Civile, Zagreb, Kroaci, 1. qershor 2010)

Pra, ti heqim luftërat dhe konfliktet e armatosura sepse nuk e kanë vendin aty. Kjo është nën a), ndërsa nën b), c), d) dhe e), dhe ja unë do ta lexoj komentim. Kjo, sipas nesh, është listë dëshirash, dhe vështirë se këto do të jenë vetëm objektiva. Kjo do të ishte listë dëshirash të cilat janë të pranueshme për rregullën ku kryhet ndonjë veprimtari, arsyet e themelimit të misionit dhe vizionit, si dhe çmimi i nevojës. Pra, mendoj se kjo duhet të formulohet shumë më qartë, dhe të mos mbetet në këtë fushë, e të mos e analizoj deri në fund fjalinë, në këtë fushë ato të ndihmojnë sadopak, të përkrahen dhe kështu me radhë, por qëllimi duhet të jetë konkret sipas nesh. (Velko Viqeviq, UDVDR PGZ, Zagreb, Kroaci, Konsultimet Nacionale me Organizatat e Shoqërisë Civile, Zagreb, Kroaci, 1. qershor 2010)

Ne mendojmë se paragrafët b), d), d), ndoshta mund të jenë pjesë e hyrjes. Pse? Për t'u kontribuar të mbijetuarve, për të kontribuar, ata që kanë kontribuar do ta pranojnë të vërtetën. Të bëjmë këtë, që do të, në fakt kjo që është në nenin 20, detyrat e KOMRA-së, të cilat janë mjaft konkrete, duhet të shkojnë drejt objektivave (qëllimeve) ose fare nuk kemi nevojë për kësi lloj qëllime, nuk di, duhet të definohet. (Katarina Kruhonja, Qendra për paqe, kundër dhunës dhe të drejtave të njeriut, Osijek, Kroaci, Konsultimet Nacionale me Organizatat e Shoqërisë Civile, Zagreb, Kroaci, 1. qershor 2010)

(...) për paragrafin nën b), kontributi në zbardhjen e fatit të zhdukurve, mendoj se kjo është shumë me rëndësi. Do të dëshiroja që kjo të mbetet në qëllime, pra, të sqarojmë se çka mund të jenë në hyrje (preambulë). (Vesna Tersheliq, Dokumenta, Zagreb, Kroaci, Konsultimet Nacionale me Organizatat e Shoqërisë Civile, Zagreb, Kroaci, 1. qershor 2010)

Neni 10.

Përbërja e KOMRA-së

(...) lidhur me numrin prej njëzet anëtarë/e, këtu thjesht do të duhej të dëgjojmë më shumë për kriteret, si kemi ardhur deri të ata numra (...) (Tin Gazivoda, Qendra për të Drejtat e Njeriut, Zagreb, Kroaci, Konsultimet Nacionale me Organizatat e Shoqërisë Civile, Zagreb, Kroaci, 1. qershor 2010)

(...) mendoj se mënyra më e drejtë do të ishte se çdo vend i cili merr pjesë në themelimin e komisionit të ketë numër të njëjtë të anëtarëve, dhe kjo ndoshta të jetë nga katër anëtarë, nëse kjo do të ishte më e lehtë për, nëse kjo do të ishte e pranueshme për Bosnje e Hercegovinën. (Slaven Rashkoviq, Dokumenta, Zagreb, Kroaci, Konsultimet Nacionale me Organizatat e Shoqërisë Civile, Zagreb, Kroaci, 1. qershor 2010)

Mendoj se duhet të kemi kujdes të jetë numër tek. Nëse është numri qift, atëherë është shumë vështirë të arrihet të pajtohen. (Mirjana Bilopavloviq, Delfin, Pakrac, Kroaci, Konsultimet Nacionale me Organizatat e Shoqërisë Civile, Zagreb, Kroaci, 1. qershor 2010)

Pra, vendosja e numrave me intensitet nuk është mirë. Gjithashtu nga pikëpamja etike mendoj se nuk është mirë të të vendoset kriteri i numrave të viktimave sepse po të hymë në përmasa, vlera e numrave se a janë këtu dhjetë apo njëqind, thjesht është në kundërshtimin me të kuptuarin tim se viktimat është viktimë, dhe se në fakt të gjithë numrat janë të njëjtë dhe të gjithë kanë rëndësinë e njëjtë.

Pra, nëse është problem se në Bosnje e Hercegovinë ligji përcakton të drejtat e barabarta për të tre popujt përbërës, dhe ata nga kjo duhet ti kenë tre, atëherë tjerët t'i përshtaten kësaj, por të jetë barabarësi në krahasim me shtetet në kuadër të këtij numri. (Liliana Canjuga, UDVDR PGZ, Zagreb, Kroaci, Konsultimet Nacionale me Organizatat e Shoqërisë Civile, Zagreb, Kroaci, 1. qershor 2010)

(...) tani paramendoni se jeni anëtar i një komisioni të tillë, dhe nga Bosnja të jenë tre persona. Njëri nga njëri, tjetri nga i dyti, dhe i treti nga entiteti i tretë. Mendoj se këtu duhet të kemi mjaft, një numër të mjaftueshëm njerëzish nga një rajon aq i ngarkuar dhe të cilët munden mes vete, të cilët sjellin përvojat, dinë të kenë atë situatë, si të them, mund të punojnë më mirë në atë komision. Mendoj se kjo është arsye pse duhet të jenë më shumë. Ky është mendimi im, por nuk di si ta arsyetoj. (Katarina Kruhonja, Qendra për Paqe, kundër dhunës dhe të drejtave të njeriut, Osijek, Kroaci, Konsultimet Nacionale me Organizatat e Shoqërisë Civile, Zagreb, Kroaci, 1. qershor 2010)

Unë më parë do të jem për versionin të zgjedhim njerëzit „me kualitete të larta të moralit“ të cilët përfaqësojnë barabartë, të jenë nga të gjitha shtetet, e jo të përfaqësojnë bashkësitë etnike. (Mario Mazhiq, Iniciativa për të Drejtat e Njeriut, Zagreb, Kroaci, Konsultimet Nacionale me Organizatat e Shoqërisë Civile, Zagreb, Kroaci, 1. qershor 2010)

(...) A do të ketë Myslimani nga Sanxhaku apo nga ndonjë zonë tjetër, si të them Myslimanët, ata ashtu quhen atje, a do të kenë besim nëse nuk e kanë përfaqësuesin e vet, për shkeljet e drejtave të njeriut që kanë ndodhë në Malin e Zi, a do t'i përfaqësojë Malazezi, a do të ketë besim Kroati nga Boka? Unë vetëm po e them këtë? Ai mund të ketë besim, por kjo është, mendoj, se në fund të fundit çdo gjë bazohet në principin nacional. (Veselinka Kastratoviq, Qendra për Paqe, kundër dhunës dhe të drejtave të njeriut, Osijek, Kroaci, Konsultimet Nacionale me Organizatat e Shoqërisë Civile, Zagreb, Kroaci, 1. qershor 2010)

Neni 12.

Kriteret për zgjedhjen e anëtarëve dhe anëtareve të KOMRA-së

Paragrafi 2, mendoj se kjo „me kualitete të larta të moralit“, çfarë është kjo? Mendoj se duhet qartësuar këtë, kjo duhet të hiqet ose të definohet qartë se cilat kriteret do të mund të plotësohen, e të mos na ndodhë që Paneli përzgjedhës të na thotë se ky person ka „cilësi të lartë morali“, ndërsa tjerët nuk pajtohen me këtë dhe thjeshtë të mos mund të pajtoheni. (...) në të njëjtin artikull, ku thuhet se anëtarët e komisionit, dy fjalë janë shumë të rëndësishme, të kenë nivel të lartë arsimimi, e këtu janë tri fjalë, nivel të lartë arsimimi që të mund të zgjidhen në komision. Pasi që kjo nuk është organizatë profesionale e as shoqatë e profesionistëve, ndërsa ne kemi në të gjitha vendet tona principin e të drejtës për votim pasiv, që do të thotë se unë mund të jem i zgjedhur nga dikush në vend. Pra, në të gjitha shtetet tona e kemi që mosha më

e ultë të jetë tetëmbëdhjetë vjeç. (Ivan Novosel, Legalis, Zagreb, Kroaci, Konsultimet Nacionale me Organizatat e Shoqërisë Civile, Zagreb, Kroaci, 1. qershor 2010)

Unë, ndoshta, do ta ndërroja këtë termin pupujt, sepse do të mund të shkaktojë konfuzitet me termin qytetarët. (Ivan Novosel, Legalis, Zagreb, Kroaci, Konsultimet Nacionale me Organizatat e Shoqërisë Civile, Zagreb, Kroaci, 1. qershor 2010)

Ne propozojmë, që paragrafi 3, të fshihet tërësisht, që këtu nuk ka nevojë për „të aftë psikikisht dhe fizikisht“ dhe „të kenë nivel të lartë arsimimi“. (Katarina Kruhonja, Qendra për Paqe, kundër dhunës dhe të drejtat e njeriut, Osijek, Kroaci, Konsultimet Nacionale me Organizatat e Shoqërisë Civile, Zagreb, Kroaci, 1. qershor 2010)

(...) nuk guxojmë assesi të lejojmë që të lihen anash personat me aftësi të kufizuara (...) Mendoj, aftësitë për punë, pra këto duhet t'i ketë personi, që ka, le të themi, aftësi të plota për punë dhe kjo dihet se çka nënkupton. Sa i përket nivelit të lartë të arsimimit, këtu duhet ta dimë, se në këtë mënyrë jemi diskriminues ndaj njerëzve të moshës tetëmbëdhjetë vjeç deri në njëzet e një vjeç, këtë natyrisht mund ta diskutojmë, por si mund t'ia sqarojmë dikujt se mund të jetë kryetar, e nuk mund të jetë komisar? (Mario Mazhiq, Iniciativa për të Drejtat e Njeriut, Zagreb, Kroaci, Konsultimet Nacionale me Organizatat e Shoqërisë Civile, Zagreb, Kroaci, 1. qershor 2010)

(...) paragrafët 1, 2, 3, 4, nuk di sa, vinë nga pozita e personave që merren me të drejtat e njeriut. Sepse, sido që ta shikoni, kjo është diskriminuese. (Liliana Canjuga, UDVDR PGZ, Zagreb, Kroaci, Konsultimet Nacionale me Organizatat e Shoqërisë Civile, Zagreb, Kroaci, 1. qershor 2010)

Neni 13.

Procedura e përzgjedhjes së anëtarëve dhe anëtareve të KOMRA-së.

Lidhur me dilemën e cila u përmend, komisioni zgjedhor (paneli përzgjedhës) ia dorëzon listën kryetarit, kryesisë së shtetit, unë mendoj së kjo është çështje e cila mund të zgjidhet me ligjin të cilin duhet ta miratojmë. Pra, nuk jam i sigurt a duhet të qëndrojë kjo këtu, kjo është ligjore, a mund të qëndrojë para se të miratohet ligji. (Tin Gazivoda, Qendra për të Drejtat e Njeriut, Zagreb, Kroaci, Konsultimet Nacionale me Organizatat e Shoqërisë Civile, Zagreb, Kroaci, 1. qershor 2010)

Tre anëtarë i emëron Ministri i i të drejtave të njeriut dhe pakicave apo Ministri i Drejtësisë. Në konsultime me anëtarët e komisioneve parlamentare dhe drejtave të njeriut, për të drejtat e njeriut, mendoj se kjo është mirë. (Tin Gazivoda, Qendra për të Drejtat e Njeriut, Zagreb, Kroaci, Konsultimet Nacionale me Organizatat e Shoqërisë Civile, Zagreb, Kroaci, 1. qershor 2010)

(...) paragrafi 4, pika g), (...) konfirmoj, Ministria për të drejtat e njeriut dhe pakicave, gjegjësisht te ne kjo do të ishte kështu, Ministria e drejtësisë, vërteton zgjedhjen e komisionit përzgjedhor. Kjo është si të sjellim një instancë shtesë. Unë jam më shumë për ndonjë formulim i cili do të gjendej të paktën në këto tekstet tona „jep pëlqimin“. (Tin Gazivoda, Qendra për të Drejtat e Njeriut, Zagreb, Kroaci, Konsultimet Nacionale me Organizatat e Shoqërisë Civile, Zagreb, Kroaci, 1. qershor 2010)

(...) mendoj se është shumë me rëndësi, që menjëherë t'i zgjedhim edhe zëvendësit e anëtarëve, sepse pastaj do ta humbim këtë mundësi... në fakt, shumë shpesh në këshille të ndryshme dhe në organe përfaqësuese, merret ai që ka të drejtën e votës si dhe zëvendësi i tij, sepse është vështirë të supozohet që të kenë mundësinë të dy të jenë prezent njëkohësisht në mbledhje. (Liliana Canjuga, UDVDR PGZ, Zagreb, Kroaci, Konsultimet Nacionale me Organizatat e Shoqërisë Civile, Zagreb, Kroaci, 1. qershor 2010)

Mendoj se shteteve, gjithashtu duhet dhënë hapësirë për mundësinë e vërejtjes kur zgjedhën njëzet komisarë/e. Pra, që secili shtet, si në rastin e zgjedhjes së ambasadorëve, pastaj shteti mund të japë ndonjë veto për atë ambasador. (Gordan Bosanac, Qendra për studime të paqes, Zagreb, Kroaci, Konsultimet Nacionale me Organizatat e Shoqërisë Civile, Zagreb, Kroaci, 1. qershor 2010)

Neni 17.

Kuorumi dhe vendimet

Kuorumi duhet të përcaktojë qartë, direkt dhe mënyrën e vendimeve. Mendoj se këto të dyja, kuorumi dhe vendimet, nuk shkojnë së bashku, nuk vjen në konsiderim. Sipas kësaj, nëse e marrim opsionin A, ajo është njëzet, do të thotë kuorumi është rreth katërbëdhjetë, dhe për kuorum është e mjaftueshme nga katërbëdhjetë dy të tretat që është nëntë e gjysmë. Do të thotë nëntë. Kjo do të thotë se më pak se 50 % nga numri i tërë i anëtarëve do të sjellë vendime. Nëse tani i lexojmë, nga dy „KOMRA mundet me dy të tretat“, sërish po përmendet dy të tretat shumicë, „për vendim për miratimin e procedurave konkrete mjafton të jetë pjesa shumicë e tyre“. Kjo është në kundërshtim me paragrafin 1. Pjesa shumicë e thjeshtë është shumica më e madhe se gjysma. Nëse kjo është njëmbëdhjetë, dy të tretat prej njëmbëdhjetë janë shtatë. Pra, 30% të anëtarëve apo komisarit, të organit sjellin vendimin. Kjo është absurde.

Pra, prania e 90 % apo dy të tretat shumicë, sipas meje, do të duhej të sjellin vendime. Kjo do të ishte, përafërsisht, nëse e shikojmë nga ana matematikore, që 60 % duhet ta sjellin vendimin. (Velko Viqueviq, UDVDR PGZ, Zagreb, Kroaci, Konsultimet Nacionale me Organizatat e Shoqërisë Civile, Zagreb, Kroaci, 1. qershor 2010)

Neni 20.

Detyrat e KOMRA-së

(...) qëndrimi im është që KOMRA të jetë më pak e ngarkuar me kontekstet dhe se është gjë shumë e madhe që KOMRA të hartojë listat, të vërtetojë faktet. (Kur është fjala për kontekstet dhe vitet, reagimi im i parë është se ajo është përcaktuar mirë. Pra, viti 1980 i caktuar për kontekst dhe kjo si thuhet 1. janar 1991 deri në fund të vitit 2001.) (Gordan Bosanac, Qendra për studime të paqes, Zagreb, Kroaci, Konsultimet Nacionale me Shoqëritë Civile, Zagreb, Kroaci, 1. Qershor 2010.)

Tashmë e kemi diskutuar në të gjitha debatet, se nuk mund t'i përziejmë viktimat e krimeve të luftës me të vrarët tjerë në atë periudhë. Është një listë për të vrarët, ndërsa për viktimat e krimeve të luftës duhet të shënohet vendi, koha dhe së paku dy apo më shumë burime të fakteve që do ta vërtetojmë ato. (Velko Visheviq, UDVDR PGZ, Zagreb, Kroaci, Konsultimet Nacionale me Organizatat e Shoqërisë Civile, Zagreb, Kroaci, 1. qershor 2010)

(...) qëllimi ynë thelbësor, në fakt është që të kontribuojmë të kuptohemi dhe të mundësojmë që shtetet të takohen dhe të bien dakord të tërheqin një vijë dhe të thonë sa pasur të vrarë, sa janë kaq të zhdukur, sa ka pasur krime lufte, sa ka pasur shkelje të rënda... kjo është ajo që duam ne, dhe me këtë do të ndihmojmë të vërtetohen faktet: çfarë konflikti i armatosur ka qenë, çka ka ndodhë e çka nuk duhet, dhe ja të qëndrojmë (...) Dhe ne jemi shumë të shqetësuar, nëse kjo do të hulumtojë kontekstin, shkaqet, motivet dhe veprimet duke filluar nga të tetëdhjetat, të cilat kanë shpjer deri te konfliktet e armatosura. Më duket se i tërë fokusi është rreth diçkaje që kursesi nuk do të mund të dakordohemi. Nëse nisemi me kontekst të cilin duhet ta kemi, mendoj së është në rregull, me shpjegimin se duhet të jenë vitet e tetëdhjeta, në fakt të nisemi nga momenti që në fakt mund të mendojmë për shpërbërjen, por më tepër të jetë një kronologji apo një pikë kthyesë, pa interpretime. Kjo në fakt, po më duket tejet ambicioze, dhe disi ne nuk pajtohemi që komisioni të merret tepër me këtë. (Katarina Kruhonja, Qendra për Paqe, kundër dhunës dhe të drejtat e

njeriut, Osijek, Kroaci, Konsultimet Nacionale me Organizatat e Shoqërisë Civile, Zagreb, Kroaci, 1. qershor 2010)

Neni 21.

Kompetenca kohore dhe territoriale e KOMRA-së

(...) Për Kroacinë termini 1. Janar 1991 është diskutabil, sepse e kemi ligjin në Kroaci i cili fillimin e luftës e konsideron në datën 1. qershor 1990. Prandaj, kemi arsye pse kemi propozuar, që fillimi i shënimit të viktimës së parë të luftës të jetë në vitet nëntëdhjetë, e jo 1991. (Velko Viqueviq, UDVD PGZ, Zagreb, Kroaci, Konsultimet Nacionale me Organizatat e Shoqërisë Civile, Zagreb, Kroaci, 1. qershor 2010)

Neve, nuk na konvenon që pikë e artë e historisë sonë, nga e cila do të shikohet konteksti në të ardhmen, të jetë vdekja e Josip Broz Titos. Në fakt, ky është akt politik. Është tejet e vështirë, përpos që është në kuptimin fizik të një personi, është tejet e vështirë të caktohet se vdekja e tij ka ndikuar deri në atë masë në ndryshimin e marrëdhënieve, apo ky ndryshim ka filluar para vdekjes së tij, apo ka ndodhë dy tre muaj pas vdekjes së tij. Për ne do të ishte shumë më e pranueshme që të jetë akt i drejtë, të jenë vitet '74, kur është miratuar Kushtetuta, nga e cila pastaj kanë dalë të drejtat e Republikave për pavarësim, gjegjësisht sovranitet si një akt i fortë politik se sa që është vdekja e një personi, pavarësisht çka ka përfaqësuar ai në këtë territor. (Liliana Canjuga, UDVD PGZ, Zagreb, Kroaci, Konsultimet Nacionale me Organizatat e Shoqërisë Civile, Zagreb, Kroaci, 1. qershor 2010)

Unë, propozoj të merret data 1.01.1990, sepse atëherë do të përfshihet tërë viti, sepse do ti jepet mundësia komisionit të ketë një vështrim më të gjerë kohor të ngjarjeve, sepse ne të gjithë, mirë e dimë, se në atë kohë kanë ndodhë ngjarje të cilat kanë pasur prapavijë me bazë etnike, e të cilat raste nuk kanë hyrë në vlerësimin e krimeve të luftës, por ndoshta kanë pasur ndikim të konsiderueshëm në ngjarjet e mëvonshme. Nëse ne vendosim të caktojmë se fillimi i konflikteve të armatosura ka qenë data 1.01.1991, gjegjësisht '91, atëherë do ta pranojmë se gjithë ajo që ka ndodhë para kësaj date ka qenë akt i terrorizmit. Ky është një dallim shumë i madh në pasojat ligjore, të cilat mund të kenë pasojë si për viktima ashtu edhe për çdo gjë tjetër. (Liliana Canjuga, UDVD PGZ, Zagreb, Kroaci, Konsultimet Nacionale me Organizatat e Shoqërisë Civile, Zagreb, Kroaci, 1. qershor 2010)

Lidhur me këtë dilemë, mendoj se kompromisi për datën 1. Janar 1980, është kompromis i mirë. (Gordan Bosanac, Qendra për studime të paqes, Zagreb, Kroaci, Konsultimet Nacionale me Organizatat e Shoqërisë Civile, Zagreb, Kroaci, 1. qershor 2010)

Unë do të thoja, se ndoshta nuk do të duhej të jepen rrethanat politike e shoqërore, por që ndoshta nga data 1. Janar 1980, të shkruhen disa fakte historike, dhe jo të interpretohet aq shumë. Pra, le të numërohen faktet që kanë ndodhë, por kam frikë se çdo interpretim do të jetë terren i rrëshqitshëm. (Gordan Bosanac, Qendra për studime të paqes, Zagreb, Kroaci, Konsultimet Nacionale me Organizatat e Shoqërisë Civile, Zagreb, Kroaci, 1. qershor 2010)

(...) ne me të vërtetë mendojmë se duhet hiqet faktet për konfliktet e armatosura. Kjo është e ndërlidhur me detyrën në paragrafin 5, sepse është tejet e gjerë. Pra, si në nenin 1, ashtu edhe në nenin 21. pra, pas kësaj RSFJ duhet të shkruhet pikë, e jo , „rrethanat politike e shoqërore“. Por, kush do ta bëjë këtë? Atëherë, viktima nuk do të jetë më në fokus, në momentin kur ne do të fillojmë të flasim për rrethanat politike dhe shoqërore, mendoj se viktima do të jetë e harruar. (Nikoleta Polak, Qendra për Paqe, kundër

dhunës dhe të drejtave të njeriut, Osijke, Kroaci, Konsultimet Nacionale me Organizatat e Shoqërisë Civile, Zagreb, Kroaci, 1. qershor 2010)

Mendoj, se nëse duam ti shënojmë humbjet në njerëz, le të marrim parasysh se janë vrarë shumë njerëz, por jo të gjithë nga krimet e luftës, prandaj nëse do të merren edhe me te, se kjo nuk është as krim luftime e as shkelje e rëndë e drejtave të njeriut, e ajo çka nënkuptohet nga kjo, por është një fakt për konfliktet e armatosura se për shembull: një ushtarë është vrarë në një vend në luftë. (Mario Mazhiq, Iniciativa për të drejtat e njeriut, Zagreb, Kroaci, Konsultimet Nacionale me Organizatat e Shoqërisë Civile, Zagreb, Kroaci, 1. qershor 2010)

„Faktet për krimet e luftës“, mendoj se nëse shkruhet kështu, vërtetë do të jetë shumë e gjerë. Mendoj se këto do të duhet të përfshihen, komisioni do të duhet të merret me mediat, me propagandën nxitëse për luftë, gazetarët, falsifikimet dhe falsifikimet e të dhënave etj. Mendoj... me përfshirjen, e propagandës së mediave por edhe të politikës, por edhe të gjithë tjerat, kur është zhvilluar cila luftë, ku ka sulmuar, kush kënd e ka granatu... Kam frikë se komisionit kjo do ti marrë shumë kohë dhe kapacitete, për vërtetimin e fakteve të konflikteve të armatosura. (Igor Roginek, Dokumenta, Zagreb, Kroaci, Konsultimet Nacionale me Organizatat e Shoqërisë Civile, Zagreb, Kroaci, 1. qershor 2010)

Neni 23.

Marrja e deklaratave

Këtu po shkruan „nga viktimat, dëshmitarët dhe qytetarët tjerë“, por askund nuk po shkruan kryesit e veprës, bashkëpunëtorët (...) dhe duhet të merren deklaratat edhe nga kryesit potencial, bashkëpunëtorët. Ata janë si qytetarët e tjerë. (Katarina Kruhonja, Qendra për Paqe, kundër dhunës dhe të drejtat e njeriut, Osijek, Kroaci, Konsultimet Nacionale me Organizatat e Shoqërisë Civile, Zagreb, Kroaci, 1. qershor 2010)

Neni 29.

Metodologjia

Mendoj, se përpos dëgjimeve publike të jepen edhe disa raporte për aktivitetet që janë zhvillu gjatë asaj jave, apo të paralajmërohen aktivitete të ardhshme. Pra, kjo do të ishte një shtesë, e cila do të vihej në atë nen apo në ndonjë tjetër. Mendoj se është e obligueshme, siç shkruan në nenin 29, paragrafi 3, që mbajtja e dëgjimeve publike të rregullohet me rregullore, a të rregullohet me këtë rregullore apo ndoshta të ketë peshë më të madhe. (Ivan Novosel, Legalis, Zagreb, Kroaci, Konsultimet Nacionale me Organizatat e Shoqërisë Civile, Zagreb, Kroaci, 1. qershor 2010)

Neni 32.

Financimi

Rreth financimit, që tani u përmend, kjo pjesë akoma nuk është shtjelluar, por është një propozim i cili ka dalë më parë në konsultime, dhe mendoj se është mjaft i rëndësishëm, se një pjesë e financimit të jetë nga ajo që tani në Kroaci është në nismë, që krimi nuk vjetrohët, as ai i lidhur me krimet financiare dhe krimet e luftës. Pra, nëse merren paratë nga njerëzit të cilët janë pasuruar gjatë luftës, dhe që këto të holla të shkojnë në KOMRA. (Gordan Bosanac, Qendra për studime të paqes, Zagreb, Kroaci, Konsultimet Nacionale me Organizatat e Shoqërisë Civile, Zagreb, Kroaci, 1. qershor 2010)

Neni 35.

Karakteri i gjetjeve të KOMRA-së

(...) nuk po kuptoj çka do të thotë kjo. A do të emëroni ju ndokënd apo me faktet e juaja të cilat e përshkruajnë situatën mund t'ia jepni këtë, Prokurorisë Shtetërore, DORH-së e kështu me radhë, por të mos nxirret raporti në të cilin do të shkruan: „Ne në bazë të kësaj konkludojmë se personi x, y është kryesi i veprës“. Kjo po më duket paksa e sforcuar. (Katarina Kruhonja, Qendra për Paqe, kundër dhunës dhe të drejtave të njeriut, Osijek, Kroaci, Konsultimet Nacionale me Organizatat e Shoqërisë Civile, Zagreb, Kroaci, 1. qershor 2010)

Neni 36.

Roli i KOMRA-së në procedimin penal

Dilemat

Si mendoni t'i definoni viktimat të cilat kanë qenë në territorin e pushtuar, kanë mbetur në territorin e okupuar dhe janë vrarë gjatë mandatit të tyre, të cilin ata e kanë pasur para kthimit të Kroacisë në territorin e vet. (Manda Patko, Shoqata e Nënave të Vukovarit, Vukovar, Kroaci, Konsultimet Nacionale me Organizatat e Shoqërisë Civile, Zagreb, Kroaci, 1. qershor 2010)